




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-16255/20 datë:21.08.2020



Npi – 01/190 datë: 27.08.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.08.2020, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 27.08.2020 (e enjte) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përvèç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rrahman Kadrija, z.Muhamed Ademaj, znj.Diarta Vishecella, z.Ruzhdi Brahim, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri; Zyrtari për Informim, z.Lulzim Sahiti; Nga OSBE-ja z.Muharrem Haziri; Zyrtari i IT-së, Gazmend Ademaj; Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rrahman Kadrija, i cili pasi përshtëndetë të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 13.05.2020, 05.06.2020, 08.07.2020,
2. Informatë nga DKA për gjendjen në arsim, me theks të veçante të komunitetit pakicë,
3. Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 13.05.2020, 05.06.2020, 08.07.2020.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 13.05.2020, 05.06.2020, 08.07.2020.**

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Ne po vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës deri sa të vjen në mbledhje drejtoresha e arsimit znj.Agime Roshaj.

Pika 2

Informatë nga ZKKK-ja për aktivitetet

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi informatën në pika kryesore. Informatën e kemi të shkruar sikurse edhe informatat tjera që i kemi bërë, prandaj mund ta lexoni, i mirëpres pyetjet ose sugjerimet e juaja, (shih dokumentin).

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; E falënderojmë OJQ-në “Loti i Jetimit” që na ka ndihmuar me pakon për 40 familje, po ashtu e falënderojmë edhe OJQ-në “Rahmeti” e cila edhe kjo na ka ndihmuar me pakon për 50 familje.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, unë dua ta njoftojë Komitetin se Organizata GIZ-i Gjerman e ka financuar furnizimin me material shkollor për 10 nxënës të komunitetit pakicë për klasën e parë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; E falënderojmë edhe UNDP-n që në bashkëpunim me Ministrinë kanë ndihmuar 35 familje ku 12 prej tyre i kanë takuar Komunitetit Pakicë, e që ndihmat i kanë marrë në formë të kuponit për blerje.

z.Muhamed Ademaj; Përshëndetje, e falënderojmë, Ibrahimin për informatën. E dimë që për shkak të Pandemisë, nuk pas shumë aktivitete. Na gjëzon fakti që do të ndërtohen edhe 2 shtëpi nga Ministria. Sa i përket, Pandemisë KOVID-19, unë mendojë se është shumë e rëndësishme që të respektohen rekomandimet e IKSHP-së. I falënderojë donatorët që kanë dhënë ndihma për ta përballuar këtë situatë. Mirë do të ishte që kur ka punë me punuar e mos me i pritë vetëm ndihmat.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Shtëpitë që kanë mbetur në gjysmë pritet që së shpejti me u përfunduar edhe ato.

Pika 3

Informatë nga DKA për gjendjen në arsim, me theks të veçante të komunitetit pakicë

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike, fjalën ja dha Agime Roshaj.

zpj.Agime Roshaj, Drejtoreshë e DKA; Përshëndetje, jemi në fazën kryesore të përgatitjeve të fillimit të viti të ri shkollor. Por siç jeni edhe ju në dijeni këtë vit shkollor jemi në një situatë jo të zakonshme, të Pandemisë. Ne do të fillojmë procesin mësimor me skenarin (A). Ne momentalisht kemi kërkuar edhe nga Kuvendi që ta japim një informatë që përfshinë edhe fillimin e viti të ri shkollor. Një informatë të tillë mund ta keni edhe ju. Nuk ka ndonjë dallim të veçantë për fëmijët e Komunitetit pakicë, por edhe nuk kemi ndonjë problem në procesin arsimor sa i përket kësaj kategorie.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, procesi mësimor a do të fillojë me orar të plotë apo me orar të shkurtuar?

zpj.Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA; Ne sot e kemi marrë vendimin që nxënësit do të fillojnë mësimin në grupe, që ne do ta organizojmë. Mirëpo nuk do të ketë mësim me ndërrime.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Drejtoresha e ka marrë përsipër që nëse ka ndonjë problem me fëmijët e komunitetit pakicë që ka të bëj me regjistrim të tyre në shkollë, ka me ju ndihmuar.

zpj.Agime Roshaj, drejtoreshë e DKA; Sa e di unë e kemi pas një rast por që i kemi ndihmuar, kështu që ne kemi interesim që të ju ndihmojmë nxënësve të komunitetit pakicë, dhe unë mendojë se ata janë të integruar mjafëtë mirë në procesin mësimor bashkë me fëmijët e komunitetit shumicë.

z.Muhamed Ademaj; Sa e di unë nxënësit e komunitetit pakicë në komunën tonë janë të integruar mjafëtë mirë, por nuk e di nëse kjo është edhe te fëmijët parashkollar. Sido që të jetë unë e përgëzoz Drejtoreshën për angazhimin dhe informatën.

Pika 4

Të Ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, Unë po dua ta ngris një shqetësim, se në lagjen tonë janë kafshuar dy të mitur nga qentë endacak. Unë nuk e di se si do të shkojnë fëmijët në shkollë kur e kemi një gjendje të tillë të pasigurt nga rreziku i qenve endacak. Kërkoj që të ndërmerr masa për sa i përket rrezikut ndaj qenve endacak sepse së shpejti po fillon mësimi dhe fëmijët duhet të shkojnë në shkollë. Kam edhe një

çështje tjetër në fshatin Gjyrkovc, ka disa projekte e që konsiderojë që është mirë, mirëpo në Shtime në disa lagje ku jeton komuniteti pakicë mendojë se janë lënë anash, p.sh. te rruga "Enver Gashi" ku qe një kohë të gjatë po anashkalohet, është e pa asfaltuar e pa ndriçim dhe pa asgjë. E njëjtë po ndodh edhe te rruga "Ardhmëria".

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Dha sqarime, se në bisedë që kam pas me Kryetarin më ka thënë se do të futet në buxhet.

z.Muhamed Ademaj; Sa i përket qenve endacak edhe unë jam i mendimit se me të vërtetë ka një problem serioz. Mendoj se DSHP-ja ka bërë diçka që gjendja të ndryshon. Ne duhet të kërkojmë që kjo çështje të trajtohet më me seriozitet, duhet të kërkojmë që kjo të jetë vijë buxhetore edhe për këtë por edhe për rrugët që kanë nevojë për asfaltim.

z.Arton Demiri; Unë i kam dy pyetje, familjet e komunitetit Rom nuk kanë ujë, pyetja është kur do të bëhen këto familje me ujë? dhe pyetja e dytë është kur do të fillojë shpërndarja e ndihmave?

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Po e dimë që lagjja e juaj nuk ka ujë, por me Kryetarin do të provojmë që të bëjmë diçka, sepse e dimë që uji po keqpërdoret. Ndihma njëherë nuk ka por po presim që të kemi së shpejti.

z.Muhamed Ademaj; Është mirë me bërë një zgjidhje për këto familje, qoftë me hapjen e puseve ose edhe me ujësjellës, unë e kuptojë gjendjen e vështirë të tyre.

z.Ruzhdi Brahimi; Sa i përket popullatës tanë është në varfëri të madhe, mendoj se ne duhet me dal në terren me pa gjendjen e tyre dhe me u munduar që me bërë një zgjidhje.

z.Muhamed Ademaj; A marrin ndihma sociale këto familje që i përmendi Ruzhdin?

z.Ruzhdi Brahimi; Po marrin por a mundet një familje me jetuar me 100 euro, disa prej tyre i kanë edhe 10 anëtarë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë jam me ty Prof, sepse nuk bënë vetëm me u ankuar, sepse Qendra për Punë Sociale nuk i len me hekë keq.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14.47 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija